



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria –Vlada-Government

*Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo
Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacija / Ministry of Education, Science, Technology and
Innovation*

Thirrje publike për nominim të anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e Republikës të Kosovës, bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë nr. 04/L-037 dhe Udhëzimin administrativ nr. 06/2018, datë 07.05.2018, shpall thirrje publike për nominimin e katër (4) anëtarëve vendorë të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC), në Agjencinë e Kosovës për Akreditim.

Të drejtën për të nominuar apo vetnominuar për anëtarë të KSHC, e kanë të gjithë personat juridikë të regjistruar në Kosovë dhe personat fizik, shtetas të Republikës së Kosovës.

Të nominuarit duhet t'i plotësojnë këto kushte:

1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës.
2. Të kenë gradën e doktorit të shkencave me përvojë relevante akademike ose dhjetë (10) vite përvojë në fushën e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë.
3. Në rast se studimet i kanë kryer jashtë vendit, duhet të kenë vendimin për njohje ose dëshminë e aplikimit për njohje të diplomës nga Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës.
4. Të kenë njohuri të gjuhës angleze.

Shënim: MASHTI, kërkon nominime për katër fusha të caktuara me Udhëzimin Administrativ nr. 06/2018, datë. 07.05.2018, sipas nenit 2:

1. Artet dhe Drejtësia;
2. Shkencat e natyrës, matematika, kompjuterika & inxhinieria, prodhimtaria dhe ndërtimi;
3. Shëndeti dhe mirëqenia, bujqësia dhe veterina.

E drejta për të nominuar:

Çdo person juridik mund të nominoj deri në gjashtë (6) kandidatë për KSHC, kurse personat fizikë mund të vetnominohen.

Dokumentacioni i nominimit duhet të përmbajë:

1. Formularin e nominimit të plotësuar dhe nënshkruar nga personi i nominuar;
2. Bashkëngjitur këtij formulari të plotësohet:
 - a) Nomini nga institucioni: Deklarata nr. 2
 - b) Vetënomini: Deklarata nr. 1.
3. Kopjen e dokumentit identifikues të personit të nominuar.
4. CV-në e nënshkruar nga personi i nominuar që dëshmon plotësimin e kriterëve nga neni 3 i Udhëzimit Administrativ nr. 06/2018, datë. 07.05.2018.
5. Kopjen e noterizuar të diplomës së doktoratës.
6. Kandidatët që nuk kanë diplomë të doktoratës, sjellin diplomat paraprake të noterizuara dhe dokumente relevante të vërtetuara nga punëdhënësit e tyre, si dëshmi për përvojën e tyre 10 vjeçare në fushën e sigurimit të cilësisë.
7. Nëse studimet janë përfunduar jashtëvendit, kopjen e Vendimit të njohjes ose dëshminë e aplikimit për njohje të diplomës nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës të Kosovës.

Vërejtje: Dokumentet e dorëzuara nuk kthehen.

Nuk mund të zgjidhet anëtar i KSHC personi që:

1. Ka ushtruar post politik në dy (2) vitet e fundit.
2. Është themelues, bashkëthemelues, aksionar, anëtar i bordit ose bartës i funksionit menaxherial në ndonjë institucion të arsimit të lartë.
3. Ka angazhim aktual në më shumë se një institucion të arsimit të lartë.
4. Ka kryer vepër penale.
5. Konstatohet se ka konflikt interesi.

Afati për nominime është pesëmbëdhjetë (15) ditë pune nga dita e shpalljes së thirrjes publike në uebfaqen e MASHTI ose deri më 17.02.2023.

Formularët e cekur më lartë të cilët janë pjesë e dokumentacionit, mund t'i gjeni në uebfaqen e MASHTI: <https://masht.rks-gov.net/category/konkurse/shpallje/>

Dokumentet e kompletuara dorëzohen në zarf të mbyllur dhe të nënshkruar në të, në zyrën 4, kati përdhes, nga ora 08:00 deri 16:00.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

Rr. "Agim Ramadani", p. n.

10000, Prishtinë, Republika e Kosovës.